



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Department

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinita Org Unit	2.2
Nr.Pr. Prot. Broj Prot. Prot.No.	05-2514
Nr./faqe Br.stranica No. pages	-20-
Data: Datum:	01/04/2026
Prishtinë / a	

KRYESE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Local Government Administration		
Data: Datum:	01.04.2026	
Data: Datum:		
Niveli organizativ	Nr. i Lëndës	Vlera
-VI-	43-211	3

Për:	z. Erblin Hetemi- Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Kopje:	Kryetar i Komunës së Shtimes Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes Z. Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm MAPL Dr.Merita Vuthaj, Drejtor i Departamentit të ShShShP Dr.Shaban Osmanj, Divizioni i kujdesit parësor shëndetësor
Përmes:	Dr. Arben Vitia- Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë Z. Jahë Gecaj, U.D Sekretar i Ministrisë së Shëndetësisë
Nga:	Znj. Aferdita Hoxha , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Znj. Kadrije Sherifi Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrje dhe zbatim të Legjislacionit/MSh, <i>Shp</i>
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Shtimes
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës për taksë tarifa dhe gjoba për vitin 2026 në Komunën e Shtimes

I nderuar Z. Erblin Hetemi- Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 8, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Rregullorja e Kuvendit të Komunës Npi-01/45, datë 05 Mars 2026 – Për taksa tarifa dhe gjoha për vitin 2026 në Komunen e Shtimes

I miratuar më datë: 05.03.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 13.03.2026

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Shëndetësisë më datë: 16.03.2026

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

#### A r s y e t i m

- Neni 10, paragrafi 10.1.2 - Në këtë dispozitë është paraparë : “Formulari për trajtim jashtë vendit”. Formulari për trajtim jashtë vendit nuk është në kompetencë të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqnje sociale sepse trajtimi mjekësor jashtë institucione shëndetësore publike është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2023 – Për trajtim jashtë institucionve shëndetësore publike.
- Neni 10, paragrafi 10.2.7 në këtë dispozitë është paraparë si shërbimi veçant: “EKG”. Ky shërbim nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2024 për bashkëpagesa, pasi që sipas këtij udhëzimi, shërbimi EKG nuk ofrohet si shërbim i veçant por trajtohet në kuadër të egzaminimeve të kujdesit parësor shëndetësor.
- Rregullorja duhet të përmbajë dispozitë që i liron nga bashkpagesa kategoritë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përkatësisht nenin 61 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe nenin 5 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2024 për bashkëpagesa për shërbimet shëndetësore.

#### Rekomandim:

- Të fshihet paragrafi 10.1.2 nga lista e shërbimeve të KPSH, pasi që tejkalon kompetencat e nivelit të kujdesit shëndetësor si dhe të fshihet dispozita 10.2.7 që të sigurohet përputhshmëria me udhëzimin për bashkë pagesa.
- Të fshihet paragrafi 10.2.27 pasi që nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2024 për bashkëpagesa
- Të shtohet një paragraf i veçantë, për lirimin nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore sipas të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe nenin 5 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2024 për bashkëpagesa për shërbimet shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,